



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°13/2022

Hagë, 07/04/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 31 mars dhe 5 prill, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelet e Kadri Veselit dhe Hashim Thaçit kundër vendimeve të Gjykatës të Procedurës Paraprake, në të cilat urdhëronte vazhdimin e mbajtjes së tyre në paraburgim.

Në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e z. Haradinaj kundër vendimeve të Trupit Gjykues, në të cilat urdhëronte vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim.

Vendimet përkatëse të Panelit të Gjykatës së Apelit mund t'i gjeni në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në çështjen *Salih Mustafa*, gjatë kësaj jave janë mbajtur seanca gjyqësore. Deri tani, Mbrojtja e z. Mustafa ka thirrur shtatë dëshmitarë për të dëshmuar. Si Mbrojtja dhe Prokuroria, ashtu edhe mbrojtësja e viktimave dhe Trupi Gjykues u kanë drejtuar pyetje disa prej dëshmitarëve. Pjesa më e madhe e dëshmive janë dhënë në seancë publike

Seanca vijuese në këtë çështje është planifikuar për të hënë, më 11 prill në orën 9:30.

Në çështjen *Pjetër Shala*, seanca vijuese për ecurinë e çështjen gjyqësore është planifikuar për të enjten e javës tjetër, më 14 prill në orën 9:30.

Pyetje nga gazetarët Nuk pati pyetje

1

